



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

PROCES – VERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

“Realizim i projektit “Odisea e Riciklimit- shfaqje teatrale për fëmijë”

Në zbatim të Nenin 21 pika 1, Neni 2, pika 2 c), Neni 33, Neni 41, pika 1 ë) dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, Nenin 11, dhe Nenin 78 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka hartuar procesverbalin për hartimin, argumentimin dhe miratimin e kriterëve të veçanta për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë:

Proçedura e këtij prokurimi është: Procedure e Hapur e Thjeshtuar

Objekt i prokurimit është: “Realizim i projektit “Odisea e Riciklimit- shfaqje teatrale për fëmijë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
22114311-5**

Fondi limit i këtij prokurimi është në masën 1.791.667 (një milion e shtaëqind e nëntë dhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa T.V.SH me fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2024.

Afati i kryerjes së shërbimit do të jetë: Nga momenti I nënshkrimit të kontratës deri në 31.12.2024

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: Nenit 49, pika 3 e Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se *“Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës.”*

Afati kohor për dorëzimin e ofertave është 10 ditë.

Kontrata: Në nenin 4, pika 20 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

“Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve, të tjera nga ato që përfshihen në pikën 19 të këtij neni.

Sa më sipër do të jetë Kontratë Shërbimi.

Nenkontraktimi:Nuk lejohet

Lejohen pagesa të drejtpërdrejta të nënkontraktorit: JO

Gjuha e prokurimit: **Shqip**

Dokumentet standarde të tenderit: Procedure e Hapur e Thjeshtuar

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i i Ofertës sipas shtojcës 1*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.* si dhe Nenit 83 “Sigurimi i Ofertës”: *Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 të konfirmuara nga organi tatimor, ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv paraqesin vërtetësi dhe besueshmëri në pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e pak se 20 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me Nenin 43, pika 1 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Gjithashtu dhe në përputhje me Nenin 55, pika 4, të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të ngjashme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së perlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni Shtetëror, për realizimin e plotë dhe të sukseshëm të kësaj kontrate.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim, duke paraqitur Faturat Tatimore, të cilat duhet të jenë sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor, të nënshkruara nga të dyja palët (ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

Kriteret e mësipërme janë vendosur sipas përcaktimeve të nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik. Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomik vërtetojnë eksperiencën në fushën objekt prokurimi dhe autoriteti kontraktor merr garancinë e nevojshme që shërbimi do të kryhet me sukses. Përvoja e operatorit është një element shumë i nevojshëm për autoritetin kontraktor, për të vërtetuar dhe qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e suksesshme të kontratës. Për kontratat e realizuara nga operatori ekonomik, operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar me qëllim të shërbejë autoritetin në vlerësimin sa më të qartë të kriterit për eksperiencat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën:

- 1 (një) Autor/Dramaturg
- 1 (një) Regjisor/ As regjisor
- 1 (një) Skenograf dhe kostumograf
- 1 (një) Koordinator/ organizator për fëmijët

Për këtë pikë, operatori duhet të paraqesë Listëpagesa ose Kontrata Pune ose Kontrata Shërbimi, të shoqëruara me Diplomat përkatëse dhe Cv për secilin nga profesionistët e mësipërm.

Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Neni 40 pika 3 I VKM nr 285 datë 19.05.2021 parashikon se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

Sa më lartë dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterit 2.3.2.

Gjithashtu në nenin 41 pika 4 Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Argumentimi i Specifimeve Teknike

Qëllimi:

Qëllimi i këtij projekti është të përvijojë detajet dhe kërkesat kryesore për zhvillimin dhe prodhimin e një shfaqjeje teatrale për fëmijët e moshës 6-12 vjeç me tema të riciklimit dhe ndotjes së mjedisit. Shfaqja teatrale synon të argëtojë, edukojë dhe frymëzojë audiencën e re për t'u bërë qytetarë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm ndaj mjedisit. Shfaqja duhet të ketë protagonistë aktorë të vegjël.

Vendi i kryerjes së shërbimit:

Operatori duhet të zhvillojë 4 (kater) shfaqje në ambiente të ndryshme në territorin që mbulon juridiksioni i Bashkisë Tiranë.

Specifikime Teknike:

1. Krijim, prodhim dhe filmim pjesë teatrale për fëmijë.

Ofruesi i përzgjedhur i shërbimit të krijimit, prodhimit dhe filmimit pjesë teatrale për fëmijë duhet të plotësojë kriteret si vijon:

1.1 Konceptimi dhe skenari i shfaqjes

- Të shkruajë një skenar që kombinon humorin, dramën dhe elementet ndërvepruese për t'i mbajtur fëmijët të angazhuar ndërkohë që japin mesazhe të rëndësishme mjedisore.
- Të sigurohet që skenari të përputhet me nivelin e të kuptuarit dhe interesat e grupmoshës së synuar.
- Të ketë eksperiencë në krijimin dhe prodhimin e veprave dramaturgjike autentike.
- Tekstet e shfaqjes duhet të jenë origjinale dhe të shkruara enkas për këtë shfaqje (nuk duhet të jenë përkthime nga gjuhë të tjera dhe jo përshtatje).
- Mesazhet duhet të jenë të lidhura direkt me tematikën e përcaktuar në thirrje.
- Të drejtat e autorit të pjesëve t'i ketë Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe do të synohet integrimi i tyre në orë ekstra kurrikulare për tematikat e mbrojtjes së mjedisit.
- Bashkëpunim me ekipin e projektit për të përcaktuar objektivat dhe mesazhet kryesore të teatrit.
- Të zhvillojë një koncept dhe skenar krijues për teatrin.
- Të sigurojë të gjitha lejet e nevojshme për provat.
- Të respektojë të drejtat e autorit për materialet që përdor.
- Të marrë me leje me shkrim për çdo person që shfaqet në teater dhe nëse përfshihen minorenë të kenë leje me shkrim nga prindërit ose kujdestari i tyre ligjor.
- Të sigurojë lejet e nevojshme për ambientet që do të përdoren për t'u realizuar shfaqja

1.2 Skenografia

- Operatori të krijojë një skenografi vizualisht tërheqëse që tregon procesin e riciklimit dhe ndikimin e tij në mjedis, ndarjes në burim dhe efektet e përdorimit të plastikës në mjedis.
- Të dizajnojë dhe ndërtojë materiale skenike shumëngjyrëshe dhe imagjinative që nxjerrin në pah rëndësinë e riciklimit.
- Të sigurojë që të gjitha pajisjet në skenë të jenë të sigurta për fëmijët dhe lehtësisht të manovrueshme.

1.3 Kostumografia

- Operatori të dizajnojë kostume të thjeshta që pasqyrojnë personalitetin e personazheve dhe theksojnë temat e riciklimit, si materialet miqësore me mjedisin dhe simbolet e riciklimit, etj.
- T'i japë përparësi komoditetit dhe sigurisë në dizajnin e kostumeve, duke marrë parasysh lëvizshmërinë e aktorëve dhe përvojën vizuale të audiencës.

1.4 Ndërveprimi me audiencën

- Operatori duhet të zhvillojë momente ndërvepruese brenda lojës që inkurajojnë fëmijët të marrin pjesë, të mësojnë dhe të mendojnë në mënyrë kritike për riciklimin.
- Të trajnojnë aktorët që të angazhohen me audiencën në një mënyrë miqësore dhe të përshtatshme për moshën.

1.5 Afatet e zbatimit

- Operatori duhet të luajë shfaqen e parë brenda 3 javëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
- Të luajë shfaqen e dytë, të tretë dhe të katërt brenda vitit 2024
*Shfaqja e dytë, të tretë dhe të katërt do të kryhet nga Operatori Ekonomik brenda 10 (dhjetë) ditësh nga kërkesa e Autoritetit Kontraktor)

2. Xhirim dhe prodhim i pjesës teatrale

- Të ofrojë shërbime profesionale të regjistrimit të videos, duke përfshirë videografinë, ndriçimin dhe regjistrimin audio.
- Të sigurojë regjistrim video cilesi jo më pak se 4k me rezolucion jo më pak se 3840 x 2160.
- Të përcjellë në mënyrë efektive mesazhin e fushatës.
- Të koordinojë dhe menaxhojë në mënyrë efikase procesin e xhirimit.

2.1 Pas prodhimit:

- Të redaktojë dhe përpunojë filmimet e xhiruara për të krijuar një produkt përfundimtar që përmbush objektivat e projektit.
- Të shtojë grafika, animacione dhe titra sipas nevojës.
- Të marrë parasysh sugjerimet nga ekipi për përmirësimin e videos dhe mesazhin e fushatës.
- Të dorëzojë videon përfundimtare në formatin “MP4” dhe “aspect ratio” 16:9.

2.2 Dorëzimet:

- Ofruesi i shërbimit të prodhimit të videos do të ofrojë sa vijon:
- Videoja përfundimtare në formatin MP4 e përshtatshme për shpërndarje online dhe offline.

3. Prodhim tabelë reklamuese trotuari me prodhim poster me adesiv nga 2 anë

- Materiali I tabelës reklamuese duhet të jetë e përbërë nga kornizë alumin me këmbë mbështetëse, që lejon mundësinë e zëvendësimit të posterit, i qëndrueshëm ndaj erës.
- Përmasat e vendit ku do të vendoset posterit në tabelë duhet të jenë 841 cm x 1189 cm

- Materiali i posterit duhet të jetë vinil ose adeziv, rezistent kundër kushteve jo të mira atmosferike, me përmasa 841 cm x 1189 cm
- Posterit informues mbi eventin duhet të jetë me ngjyra dhe të transmetojë mesazhin e shfaqjes, të përfshijë logon dhe emrin e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.
- Në përfundim të kontratës, tabela do të dorëzohet pranë autoritetit kontraktor.

Afatet e ekzekutimit: Nga momenti i lidhjes së kontratës deri në 31.12.2024

Vendi i Ekzekutimit: Brenda Juridiksionit të Bashkisë Tiranë.

Specifikimet Teknike janë hartuar nga struktura/ grup pune për objektin që prokurohet, I ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Këto specifikime përshkruajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që vlerëson shërbimin si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e Nenit 4 pika 38 të Ligjit 162/2020 si dhe Nenit 41 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021